


REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIE E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION	
Numri i Aplikimit 01	Numri i Dokumentit 105
Numri i Postës 2	Data e Aplikimit 08.01.20
PRISHTINE/A	



REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIE E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION	
Numri i Aplikimit KM-MIT	Numri i Dokumentit 009/20
Numri i Postës 2	Data e Aplikimit 08.01.20
PRISHTINE/A	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit**  
**Ministarstvo Infrastrukture i Transporta**  
**Ministry of Infrastructure and Transport**

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 26 dhe 27 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. Aprovohet kërkesa nr.12440 datë 22.11.2019 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "Arbeni Tours" sh.p.k. me seli në Ferizaj për marrjen e nisjes në relacionin: Shtime - Ferizaj dhe anasjelltas me orare të nisjes (14:00 - 14:50).
- II. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, ka

plotësuar kushtet ligjore për ndarjen e nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për marrjen e nisjes ne relacionin: Shtime - Ferizaj dhe anasjelltas me orare te nisjes (14:00 - 14:50).

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

mo

**Këshilla Juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.